

## **Hapet thirrja për bursa për studentët në kuadër të Programit Erasmus + në Universitetin e St. Kliment Ohridski, Bullgari, për semestrin e parë të vitit akademik 2021-2022.**

Në kuadër të Programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin St. Kliment Ohridski, Bullgari për semestrin e parë të vitit akademik 2021-2022.

<https://www.uni-sofia.bg/eng>

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

### **Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Bachelor;
- Master;

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- Bachelor (1 semestër);
- Master (1 semestër);

### **Fushat e studimit:**

- Gjuhë Frënge;
- Gjuhë Bullgare;
- Biologji (mund të aplikojnë vetëm studentët e nivelit bachelor);

\*Studentët e vitit të tretë Bachelor dhe studentët e vitit të dytë Master nuk mund të aplikojnë.

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti St. Kliment Ohridski, klikoni në adresën:

<https://erasmus.uni-sofia.bg/site/income/courses/course-list-for-the-2020-2021-academic-year/>

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor 800 Euro në muaj për studentët;
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

| <b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b><br>( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> ) | <b>Kompensimi</b> |
|--|-------------------|
| <b>Midis 100 dhe 499 KM</b>  | 180 EUR           |
| <b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>   | 275 EUR           |
| <b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>  | 360 EUR           |
| <b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>  | 530 EUR           |
| <b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>  | 820 EUR           |
| <b>8000 KM ose më shumë</b>  | 1100 EUR          |

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:**

-CV (në gjuhën angleze);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studenti (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Listë notash (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze;

-Certifikatë e gjuhës së huaj;

-\*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin St. Kliment Ohridski lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning\\_agreement\\_for\\_studies\\_Erasmus\\_outgoing-2-1.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx)

### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:**

-CV (në gjuhën angleze);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studentit (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Diplomë e nivelit Bachelor;

-Listë notash e nivelit Bachelor (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Listë notash e nivelit Master (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze;

-Certifikatë e gjuhës së huaj;

-\*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Mobility Plan’’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin St. Kliment Ohridski lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:*

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning\\_agreement\\_for\\_studies\\_Erasmus\\_outgoing-2-1.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx)

Afati për aplikim: **30 Prill 2021**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara përmes postës elektronike në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!